



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 32/8 Prot.

Durrës, më 17.01.2020

VENDIM

Nr. 9, datë 17.01.2020

"Për miratimin e diplomimit të studentëve të programit master "Mësuesi për Arsimin fillor nga Kl. I-VI", si studentë të diplomuar në master shkencor"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Statutit të Universitetit, të Rregullores së Universitetit, në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Edukimit Nr. 32, Datë 10.01.2020, "Propozim mbi diplomimin e studentëve të regjistruar në vitin akademik 2016-2017 dhe 2017-2018 në programin e studimit master "Mësuesi për Arsimin fillor nga Kl.I-VI", Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 17.01.2020,

V E N D O S I :

1. Miratimin e propozimit të dekanes së Fakultetit të Edukimit mbi diplomimin e studentëve të regjistruar në vitin akademik 2016-2017 dhe 2017-2018 në programin e studimit të ciklit të dytë master në "Mësuesi për Arsimin fillor nga Kl.I-VI", si studentë të diplomuar në master i shkencave.
2. Për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi ngarkohen :
 - Zv.Rektorët
 - Dekani i Fakultetit të Edukimit
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Ksanela **SOTIROFSKI**